



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJES
KËSHILLI I BASHKISË



V E N D I M

Nr. 75 Datë 25 / 10 /2019

P Ë R

“Për largimin nga lista shumemërore e subjektit politik e PSD e këshilltares Indrita Shkreli”

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 50, pika 2 ... *Këshilltari që mungon me arsye në bërjen e betimit betohet në mbledhjen më të parë që merr pjesë. Këshilltari, që nuk pranon të bëjë dhe të nënshkruajë betimin, konsiderohet se jep dorëheqjen dhe atij nuk i jepet mandati.*

Për sa më sipër, i propozohet Këshillit të marrë vendimin **si më poshtë:**

Këshilli i Bashkisë Vau Dejës, në mbledhjen e datës 25. 10 .2019

V E N D O S I:

1. Të largojë nga lista shumemërore e subjektit politik e PSD e këshilltares Indrita Shkreli, për shkak se nuk është paraqitur në dy mbledhjet e para të Këshillit Bashkiak për të bërë betimin dhe nuk ka dhënë arsye për mungesën . Mbështetur në nenin 50, pika 2 e Ligjit nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” , këshilltari që nuk pranon të bëjë dhe të nënshkruajë betimin, konsiderohet se jep dorëheqjen dhe atij nuk i jepet mandati.
2. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 te Ligjit nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”
3. Ky vendim u shpall me datë 29 / 10 / 2019

KRYETARI

MARK BISHA



SEKRETARI

ARDIAN ÇELEPIJA